

## Shtojca 1: Termat e Referencës / Përshkrimi i shërbimit

Titulli i programit:	KCSF – Departamenti i Hulumtimit
Titulli i kontratës:	Anketa me organizata të shoqërisë civile

### Informata mbi KCSF-në

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që përkrahë zhvillimin e shoqërisë civile dhe nismat që promovojnë një kulturë demokratike dhe i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të Kosovës, me fokus të veçantë në dhënien e kontributit për procesin e integritimit në Bashkimin Europian.

Me punën programore të ndërlidhur përgjatë programeve të ndryshme, KCSF është e organizuar në dy departamente kryesore funksionale:

1. Departamenti i grant-dhënies – e fokusuar në ofrimin e përkrahjes financiare dhe jo-financiare për organizatat dhe nismat e shoqërisë civile në Kosovë;
2. Departamenti i hulumtimit, avokimit dhe ngritjes së kapaciteteve – e fokusuar në ofrimin e argumenteve dhe rekomandimeve faktike, për avokim në fushat kryesore të KCSF-së, si dhe informatave dhe ngritjen e kapaciteteve të OShC-ve dhe aktorëve tjerë relevant për zhvillimin e shoqërisë civile .

Në punën e vet, KCSF ka siguruar përkrahje afat-gjatë nga një grup i gjerë i donatorëve, përfshirë Sida-n suedeze, Zyrën zvicerane për bashkëpunim në Kosovë, Bashkimin Europian, Ambasadën norvegjeze në Kosovë, Qeverinë e Luksemburgut, USAID-in amerikan, Fondacionin për shoqëri të hapur, etj.

KCSF përkrahet nga Sida, nëpërmjet përkrahjes institucionale për KCSF-në në arritjen e misionit dhe zbatimin e strategjisë së organizatës pjesë e së cilës është edhe realizimi i Indeksit Kosovar të Shoqërisë Civile 2021.

### Për Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është një studim i rregullt i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile. Ky studim vlerëson gjendjen e shoqërisë civile në Kosovë në baza periodike, duke matur dimensionet kryesore të këtij sektori, siç janë: struktura e sektorit, korniza ligjore, qeverisja dhe kapacitetet e brendshme, angazhimi qytetar, financimi, ndikimi i perceptuar dhe ambienti i jashtëm për veprimtari të shoqërisë civile.

Ky studim e vazhdon traditën e KCSF-së në ofrimin e informatave gjithëpërfshirëse mbi sektorin e shoqërisë civile në Kosovë, e filluar me [Antologjinë e shoqërisë civile më 2001](#), [Analizën e shoqërisë civile në Kosovë më 2005](#), [Indeksin e Shoqërisë Civile për Kosovë të CIVICUS më 2011](#), [Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile më 2014](#), [Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile më 2016](#), [Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile më 2018](#) dhe [Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile më 2020](#). Raporti i plotë i këtij

studimi publikohet çdo dy vite dhe i vlerëson dimensionet kryesore të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë. Ndërsa, një formë më e thjeshtuar e Indeksit publikohet çdo vit.

Metodologjia e studimit bazohet në botimet e kaluara të Indeksit të Shoqërisë Civile, por ka përshtatje të metodave hulumtuese për të adresuar karakteristikat e veçanta të shoqërisë civile në Kosovë. Metodologjia përfshin hulumtimin e literaturës dhe rishikimin e kornizës ligjore, anketa, diskutime në grupe të fokusit dhe analizë të të dhënave.

Duke paraqitur shpjegime të detajuara të një numri të madh të indikatorëve, raporti i plotë i Indeksit Kosovar për Shoqëri Civile u dedikohet për përdorim ekspertëve, hulumtuesëve dhe profesionistëve, si dhe vendim-marrësve në institucionet publike, organizatat donatore dhe OShC-të të cilat merren me sektorin e shoqërisë civile.

## **KUSHTET E VEÇANTA TË ANGAZHIMIT TË KOMPANISË/ORGANIZATËS/EKSPERTES/IT**

### **Qëllimi i kontraktimit:**

I/E kontraktuari/a do të udhëheqë dhe realizojë punët rreth mbledhjes, organizimit të të dhënave të mbledhura në terren për Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile 2021.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e veçanta**

#### **Mbledhja dhe organizimi i të dhënave sasiore dhe cilësore**

- a. Familjarizimi me pyetësin, i cili përbëhet prej rreth 130 pyetjeve dhe i cili mesatarisht kërkon rreth 90 minuta për t'u plotësuar;
- b. Anketimi në terren i 101 organizatave të shoqërisë civile, në kuadër të Anketës me OShC;
- c. Futja e të dhënave nga anketat në format të përshtatshëm dhe lehtë të përdorshëm, duke përfshirë bazën e të dhënave në format Excel dhe dokumentin sqarues të bazës së të dhënave (Code Book); si dhe, dokumentin (file) e të dhënave në formatin .sav (SPSS) me të gjitha variablat;
- d. Paraqitja tabelare e listës së respondentëve të kontaktuar, e atyre që i janë përgjigjur anketës dhe lista e respondentëve që kanë refuzuar të përgjigjen. Për secilin refuzim, të mbahet një shënim rreth arsyes së refuzimit;
- e. Mbledhja, kodimi, dhe sistemimi i pyetësorëve të plotësuar.

### **Tjera**

Deri sa mostra e shtresuar e anketës është e dizajnuar dhe t'i ofrohet palës/palëve të kontraktuara nga KCSF, ata duhet të bëjnë:

- a. Identifikimi i anketuesëve dhe sigurimi i pjesëmarrjes së plotë të tyre në trajnimin fillestar të organizuar nga KCSF lidhur me përmbajtjen e pyetësorit;
- b. Informim i rregullt, javor (çdo të premte) i KCSF rreth ecures së punës përmes raporteve të shkruara, ku ndër të tjera përfshihen edhe informatat mbi respondentët e anketuar dhe informatat e tyre të kontaktit;
- c. Takime të rregullta, varësisht prej nevojës, me stafin e KCSF-së me qëllim të koordinimit të punës.

### **Produktet e pritura:**

- a. Bazat e organizuara e të dhënave nga Anketa me OShC;
- b. Kopjet origjinale të pyetësorëve nga Anketa me OShC, apo e njëjta në format digjital (në rastet kur anketat bëhen me mjete digjitale).
- c. Lista e respondentëve të kontaktuar, të intervistuar, dhe refuzimeve.

**Periudha kohore:**

Jo më vonë se 1 javë pas nënshkrimit të kontratës, dorëzimi në KCSF për aprovim i planit të detajuar të punës dhe përcaktimi i datave të përafërta për aktivitetet kryesore të kontratës, sipas orarit të fazave kryesore si më poshtë:

- a. Trajnimi i hulumtuesve për realizimin e anketave në terren – pjesa e parë muajit janar 2022;
- b. Anketa me OShC – janar - shkurt 2022;
- c. Futja dhe organizimi i të dhënave kuantitative dhe dorëzimi i bazës së të dhënave – Deri me 10 mars 2022;

**Gjuha e punës:**

Komunikimi dhe dorëzimi i produkteve finale duhet të jenë në gjuhën shqipe.

**E drejta e përdorimit**

Të gjitha informatat, analizat dhe materialet e prodhuara në kuadër të këtij angazhimi mbesin pronë intelektuale e KCSF-së. Kompania/Organizata/Ekspertja/i i/e kontraktuar duhet të përmbahet nga përdorimi i informatave, analizave apo materialeve të marra në posedim ose të prodhuar nga ky angazhim për çfarëdo qëllimi tjetër, përveç nëse një gjë e tillë bëhet në marrëveshje me shkrim me KCSF-në. Ky kufizim përfshin edhe periudhën e zbatimit të këtij angazhimi.

## **KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR KUALIFIKIM**

### **Deklarata nën Betim nga Personi Juridik/Fizik dhe Parandalimi i Konfliktit të Interesit**

Të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin Deklaratën nën betim për kriteret e përjashtimit dhe parandalimi i konfliktit të interesit (shih Shtojcën 2), të nënshkruar nga përfaqësues i autorizuar i kompanisë ose personi fizik dhe duke cekur datën, duke deklaruar se ata nuk janë në një nga situatat e përjashtimit të renditura në Shtojcën 2.

### **Propozimi Teknik**

Propozimi teknik duhet të mbulojë të gjitha elementet e kërkuara në specifikimin teknik dhe të sigurojë të gjithë informacionet e nevojshme për të zbatuar kriteret e dhënies së kontratës. Ofertat që devijojnë nga kërkesat ose nuk mbulojnë të gjitha kërkesat mund të refuzohen në bazë të mosrespektimit të specifikimeve të tenderit.

### **Propozimi Financiar**

Çmimi në propozimin financiar duhet të kotohet në euro. Çmimet duhet të kotohen pa përfshirë TVSH-në pasi që KCSF përjashtohet nga tarifat e tilla dhe mallrat ose shërbimet duhet të ofrohen me çmime fikse të njësisë.

### **Kushtet tjera**

Ofertat e pranuar pas datës së pranimit të kërkesës të përcaktuar në ftesën për propozime ose të dorëzuara në mënyrë jo të saktë në përputhje me këto udhëzime, mundet që, me diskrecionin e vetëm të KCSF-së, të mos merren parasysh dhe të kthehen mbrapa dhe refuzohen.

Nëse ofertuesit kanë ndonjë pyetje ose kërkesë për informacion shtesë, ato duhet të dorëzohen përmes postës elektronike në emalin e cekur në Ftesën për kuotim të çmimit, me kohë për të mundësuar përgjigjen, deri me datë 6 janar 2022.

KCSF rezervon të drejtën për të refuzuar ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar ose kërkesat për shpjegime shtesë nga kjo ftesë për propozime.

Asnjë ofertë dhe asnjë pjesë e saj nuk do të konsiderohet se është miratuar, përveç nëse për miratimin e tillë ofertuesi është njoftuar me shkrim nga KCSF.

KCSF rezervon të drejtën për të ndërprerë ose modifikuar këtë ftesë.

Para dhënies së kontratës, KCSF mund të kërkojë nga ofertuesit që të ofrojnë informata shtesë për të ndihmuar procesin e vlerësimit.